

RAPORT I DEBATIT

# *Zhvillimi kulturor në Kosovë*

2014, Prishtinë



**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të  
kulturës të Kosovës

[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)





**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës  
[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)

*Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.*

*“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”*

RAPORT I DEBATIT

# Zhvillimi kulturor në Kosovë

**Autore:** Erinë Mulolli



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

# Përmbajtje

Hyrje

Përmbledhje e diskutimeve të përgjithshme rreth raportit

Strategjia zhvillimore e kulturës në Kosovë

Kornizat ligjore dhe politikat aktuale të kulturës

Shoqëeria civile

Institucionet e pavarura të kulturës

Rekomandimet

# Hyrje

Fokus grupi “Zhvillimi kulturor në Kosovë”, u mbajt më 30 shtator 2014 në Prishtinë, në kuadër të projektit Forumi për Zhvillim Kulturor. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë, ndërsa bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Diskutimi në fokus grup u orientua rreth çështjeve të trajtuara në hulumtimin e projektit që po e analizon zhvillimin kulturor të Kosovës përmes rishikimit të politikave aktuale kulturore në të dyja nivelet e qeverisjes.

Hulumtimi ka tentuar të identifikoj nivelin e demokratizimit në politikat aktuale dhe pozitën e institucioneve publike të kulturës dhe institucioneve të pavarura të kulturës në Kosovë në sistemin e krijuar politik.

Panelistë të debatit ishin: Hajrulla Ceku, Drejtor i “Ec Ma Ndryshe”, Albert Heta, Drejtor i Stacion CCA Vullnet Sanaja, përfaqësues i Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Pejë dhe Drejtor ekzekutiv i Anibarit, Dren Pozhegu, hulumtues në institutin “GAP”, Hana Qena, Drejtore e “Skena UP”, Rozafa Basha, koordinatore e projektit në “EC Ma Ndryshe”, Skender Boshtrakaj, Florent Mehmeti, drejtor i teatrit “ODA”, Donjetë Murati Stacion CCA, Valon Ibraj.

# Përmbledhje e diskutimeve të përgjithshme rreth raportit

Hulumtim i politikave qeverisëse në kulturë në Kosovë i realizuar nga qendra për art bashkëkohor STACION ka qenë bazë e diskutimeve të fokus grupit. Fillimisht Hajrulla Ceku nga “EC Ma Ndryshe” foli rreth projektit në përgjithësi dhe qëllimit të formimit të Forumit Kulturor si dhe vlerësoi hulumtimin si një kapital që tenton të zbërthej sektorin e kulturës në Kosovë.

Albert Heta, nga STACION dhe njëri nga autorët e hulumtimit prezantoi të gjeturat kryesore të hulumtimit të citat edhe u bënë temë diskutimi gjatë këtij fokus grupi. Pjesa më e madhe e diskutimit u zhvillua rreth dokumentit “Strategjia zhvillimore e kulturës në Kosovë”, duke vazhduar më pas me rregullimin ligjor, institucionet e pavarura dhe mungesën e hulumtimeve nga ana e shoqërisë civile për politikën e MKRS-së.

Duke komentuar raportin/hulumtimin në përgjithësi, Skender Boshtrakaj kishte vërejtjet e tija sa i përket gjuhës me të cilën është përpiluar raporti, strukturës, se si raportit i mungon një model referent, si dhe buxheti duket se është përmendur më shumë se që duhet.

# Strategjia zhvillimore e kulturës në Kosovë

Hulumtimi fillimisht është marrë me një historik të zhvillimeve të politikave në përgjithësi. Strategjia e parë e kulturës e quajtur “Strategjia për zhvillimin e kulturës në Kosovë 2001-02” ka qenë dokumenti i parë strategjik i përpiluar nga ndonjë ministri në Kosovë. Procesi i punës për të krijuar një strategji të tillë, dhe çfarë përmban strategjia kujtohet pak nga njerëzit të cilët ishin pjesë e procesit. Publiku sot nuk ka qasje në dokumentet finale të prodhura nga ky proces.

Publiku nuk ka qasje as në dokumentet që e kanë udhëhequr këtë proces. E tëra që ka arritur të sigurohet sipas autorit të hulumtimit Albert Heta ka qenë drafti final i strategjisë i cili është siguruar nga kanalet jozyrtare si dhe dokument i përblehur në 20 faqe. Shqetësim i pjesëmarrësve ka qenë se si ka mundësi që pas një punë sic thuhet 2 vjecare për përpilimin e një strategjie të tillë, ajo nuk u publikua asnjëherë e shumica nuk e dijnë as për ekzistencën e një dokumenti të tillë. Të njejtin shqetësim e ndan edhe Albert Heta, duke thënë që është paradoksale fakti që pavarësisht kësaj, sot ka disa zyrtarë në Ministrinë e Kulturës të cilët thonë se ende i referohen këtij doku-

menti dhe është zbatu pjesërisht.

Gjatë diskutimit Skender Boshtrakaj ka kontestuar bartësit dhe kohën kur është inicuar ky proces, si dhe ka insistuar se bëhet fjalë për dy dokumente të ndryshme. Gjithashtu është debatuar në lidhje me atë se a i ka kaluar koha kësaj strategjie, a është relevante me ditët e sotme dhe a kemi nevojë për një strategji të re.

# Kornizat ligjore dhe politikat aktuale të kulturës

Sipas hulumtimit del që në ligjet e vjetra (Ligji për teatrin dhe ligjet të tjera) vërehet fryma e strategjisë dhe hartuesit e tyre iu kanë referuar asaj. Ndërsa ligjet e reja janë largë strategjisë. Dren Pozhegut, autor i raportit “Politikat kulturore dhe Ndarja buxhetore për kulturën në Kosovë”, theksoi se është shumë shqetësuese fakti që ka mungesë të politikave kulturore, ndërsa sygjeroi që korniza afatmesme e shpenzimeve të jetë e përfshirë në raport, si dhe raporti të merret edhe me komunat dhe jo vetëm me nivelin qendror. Ndërsa, Albert Heta në këtë pikë potencoi se nuk është që nuk ka politika, por problem qendron në atë se si i quajnë dhe si i krijojnë ato. Hajrulla Ceku tha nuk kemi një dokument integral të cilit mund t’i referohemi si politika kulturore e Kosovës, apo modeli kulturor.

Janë disa ligje të mira që janë miratu, po janë edhe disa shumë të rëndësishme që nuk janë miratu, apo që edhe nuk do të miratohen, psh. “Ligji për sponzorizime” e cila thuhet se është pjesë e programit legjlativ për vitin 2014. Ndërkaq pjesë e programit legjlativ nuk është “Projekti për artistët dhe krijuesit të pavarur”.

Në këtë pjesë është diskutuar edhe për komisionin e Kuvendit për kulturë, rolin e tij, si dhe mundësinë e ndikimit në të për ti shtyrë përpara ligjet e nevojshme. Mirëpo, pikërisht kjo pikë ka mbetur e pambuluar në hulumtim, për shkak të pamundësisë së kontaktimit të antarëve të këtij komisioni.



# Lidhja e shoqërisë civile me kulturën

Gjatë diskutimit u përmend nevoja e përfshirjes së shoqërisë civile në secilin proces. Shfrytëzimi i të gjitha mekanizmave për të ushtruar presion në mënyrë institucionale, duke marrë për bazë memorandumin bashkëpunues në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë.

Një pikë e rëndësishme e kësaj Strategjie, relevante edhe për këtë hulumtim, është fuqizimi i rolit mbikëqyrës të organizatave të shoqërisë civile në punën e Qeverisë gjatë përgatitjes së ligjeve dhe rregulloreve. Sipas Albert Herës, duhet një koordinim më i madh me CIVIKOSin si platformë që përfaqëson shoqërinë civile në këtë memorandum.

Gjithashtu, sektori duhet të angazhohet që të ketë hulumtime sektoriale, ashtu sic janë bërë hulumtimet për buxhetin, komunat etj, të bëhen edhe hulumtime për muzikë, teatër.

# Institucionet e pavarura të kulturës

Një pjesë e hulumtimit merret edhe me pozitën e institucioneve të pavarura të kulturës në politikat aktuale të kulturës në Kosovë. Gjatë diskutimit u përmend fakti se si institucionet e pavarura të kulturës nuk regjistrohen si institucione të pavarura në MKRS dhe nuk ekziston ndonjë procedurë për regjistrimin e tyre. Institucionet e pavarura të kulturës, në bazë të legjislacionit në fuqi, që mundëson ekzistencën e tyre, janë të rexhistruara si “shoqata ose fondacione joqeveritare, jo-fitimprurëse që në misionin e tyre

kanë edhe zhvillimin e veprimtarive kulturore.”

Është interesantë një e dhënë që ka dalë prej hulumtimit në lidhje me ekzistimin e Galerisë së Ministrisë së Kulturës. Kjo Galeri ligjerisht nuk ekziston si institucion, mirëpo nga ana e MKRS-së përkufizohet vetëm si një zyre në Departamentin e Kulturës. Kjo Galeri merr buxhet prej të dy vijave buxhetore, edhe prej vijës buxhetore për institucione publike, edhe nga vija buxhetore që marrin prej subvencioneve. E kjo lë hapësirë me kuptim që në të ardhmen psh ODA nuk është e pamundur të merr buxhet edhe prej vijës buxhetore për institucione publike, pra

nuk ka pengesë ligjore.

Në pyetjen e ngitur se a ka MKRS-ja një databazë së paku të institucioneve që i ka nën varfësi të saj, është dhënë informacioni se të gjitha janë të listuara në një dokument apo rregullore të brendshme, e cila është bërë në kohën kur MKRS-në e drejtonte Lutfi Haziri.

Qështje tjetër që është me rëndësi të diskutohet janë edhe këshillat e organeve institucionale. Këshillat propozohen prej Ministrit. Është me rëndësi të dihen saktë se cili është roli i këtyre këshillave, sa kanë të drejtë vendimmarrjeje ata në një institucion.

# Buxheti

Ministria e Kulturës ka dy vija buxhetore prej së cilave subvencionon projekte të kulturës. Njëra vijë buxhetore është ajo që i jipen insticioneve publike kurse institucionet e pavarura marrin prej subvencioneve. Gjatë diskutimit u fol për atë se sa investohet në një institucion të caktuar ka rëndësi, sepse kur nuk investon atëherë edhe nuk ki te drejtë morale me kërkua cilesi.

Te buxheti është iniciimi i raportit të Dren Pozhegut me të gjeturat e tij. Shifrat tregojnë se buxheti i MKRS-së është rritë, mirëpo jo edhe buxheti i kulturës. Madje ai ka pësua vetëm ramje. Albert Heta theksoi që sa i përket buxhetit ky raportë më shumë është marrë me mënyrën qysh është shpërnda buxheti tek institucionet publike dhe ato të pavarura. Si dhe me atë se si shfrytëzohen subvencionet.

Në diskutim u fol për atë se si MKRS tenton të kujdeset për institucionet publike, madje komunikon edhe me donatorë për ti përkrahur këto institucione. Pra, përveç vijës buxhetore të ndarë për këto institucione, në raste të caktuara kërkon edhe t'ju gjej financim shtesë. Ndërsa, në anën tjetër, MKRS nuk është e obliguar me ligj që s'ju gjej skenës së pavarur buxhetin.

Sipas drejtorit të teatrit ODA, Florent Mehmetit, MKRS duhet të filloj të mas kualitetin e aktiviteteve kulturore që prodhojnë institucionet publike. Sipas tij, për krijimin e kualitetit, duhet të ketë marrëdhënje të kufizimit të buxhetit. Sipas Albert Hetës, instancë vlerësuese për vlerësimin e këtyre institucioneve Ministri i MKRS-së e sheh këshillin e tyre. E prandaj pikërisht këtu qëndron edhe problemi, se organin tënd duhet me vlerësu një trup i pavarur.

Florent Mehmeti theksoi se në botë performanca e institucioneve publike matet përmes të hyrave vetanake. Përderisa në vende të tjera institucionet publike financohen prej shtetit jo në tërësi, në Kosovë ndodhë kjo praktikë, e pastaj është e vështirë të pritët edhe cilësi prej atij institucioni, të cilat pasivizohen.

# Rekomandimet

Në bazë të diskutimeve të zhvilluara gjatë fokus grupit rezulton edhe lista e mëposhtme e rekomandimeve:

- Nevoja për një strategji të re zhvillimore të kulturës së Kosovë
- Pjesëmarrje në të gjitha fazat e hartimit të ligjeve/ndikimi
- Duhet të bëhet standardizimi i nocioneve brenda legjislacionit në lidhje me institucionet (institucione private, publike, kulturore)
- Bashkëpunimi i shoqërisë civile për aspektin e kulturës
- Duhet të bëhen hulumtime sektoriale

# Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjet i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave

të pavarura kulturore duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,
- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,
- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Forumi Kulturor synon të përmbush misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:

- Komunikimit dhe rrjetëzimit të organizatave të pavarura në fushën e kulturës.
- Shkëmbimit dinamik të informacioneve dhe të përvojave.
- Aktiviteteve të lobimit dhe avokimit
- Trajnimeve specifike për nevojat e organizatave anëtare

- Organizimit të debateve dhe forumeve
- Bashkërenditjes së aktiviteteve artistike dhe kulturore

# Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt i cili ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikën kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ndërsa bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013 ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.

[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Implementuar nga:





*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*